

**STATUTI I SHOQATËS SË MINIBASKETBOLLIT TË
FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS**

Në bazë të nenit 1,dhe nenit 9 pika 1 të statutit të FBK-së, në mbledhjen e kuvendit të shoqatës i mbajtur me datën _____,miratohet statuti Shoqatës së Minibasketbollit të Federatës së Basketbollit të Kosovës.

-I- DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Shoqata e Minibasketbollit e cila vepron në kuadër të FBK-së,është Shoqatë që merret me organizimin e çdo aktiviteti të minibasketbollit në Kosovë.

Neni 2

Emërtimi i plotë i shoqatës është:Shoqata e Minibasketbollit e Federatës së Basketbollit të Kosovës. Në komunikim me subjektet tjera përdoret dhe shkurtesa SHMFBK.

Neni 3

SHMFBK është pjesë integrale e FBK-së,e cila është autonome në organizimin e aktiviteteve të minibasketbollit në Kosovë. SHMFBK ka vulën katrore dhe atë të rrumbullakët, në pjesën e brendshme të së cilës ndodhet mbishkrimi: Shoqata e Minibasketbollit e Federatës së Basketbollit të Kosovës-Prishtinë.

-II- QËLLIMET E SHOQATËS

Neni 4

Qëllimet kryesore të Shoqatës janë:

- Organizimi i aktiviteteve të minibasketbollit në Kosovë.
- Zbatimi strikt i rregulloreve të FIBA-ës, në organizimin e aktiviteteve të minibasketbollit.
- Ngritja e nivelit organizativ të minibasketbollit, masovimi i lëvizjes së minibasketbollit dhe krijimi i qendrave të reja të minibasketbollit.
- Organizimi i seminareve, kurseve dhe liçencimin e trajnerëve për minibasketboll.
- Ngritja e propozimeve, qëndrimeve, mendimeve dhe iniciativave mbi të gjitha çështjet që janë me interes të përbashkët, për të gjithë anëtarët e Shoqatës.
- Lidhja me Shoqatat tjera të minibasketbollit jashtë vendit,në bashkëpunim me FBK -në.
- Aktivitet tjera të cilat i përcaktojnë organet e Shoqatës në bashkëpunim me FBK -në.

-III- ORGANET E SHOQATËS

Neni 5

Organet e Shoqatës janë:

- Kuvendi
- Bordi drejtues
- Kryetari i Shoqatës
- Sekretari i Shoqatës
- Këshilli mbikëqyrës

Neni 6

Kuvendi i Shoqatës është organi më i lartë i qeverisjes. Kuvendin e përbëjnë përfaqësuesit e Shkollave të minibasketbollit dhe tre përfaqësues të FBK -së.

Neni 7

Anëtarët e kuvendit zgjedhen në periudhën 4-vjeçare dhe mund të rizgjedhen edhe për një mandat.

Neni 8

Mandati i anëtarëve të Kuvendit pushon para se të kalojë afati për të cilin është zgjedhur:

- Nëse jep dorëheqje
- Nëse revokohet nga bazat delegeuse

Neni 9

Në kuadër të të drejtave dhe detyrave të veta Kuvendi:

- Aprovon statutin dhe aktet tjera të shoqatës që duhet të jenë të koordinuara dhe në harmoni me aktet e FBK-së.
- Përcakton themelet e punës së shoqatës dhe vendos për të gjitha çështjet esenciale të rëndësishme për punën e shoqatës, në bashkëpunim me organet e FBK-së.
- Përcakton bashkëpunim me organet e FBK-së dhe SHTFBK-së.
- Aprovon plan-programin e punës së Shoqatës.
- Miraton propozicionet e garave të minibasketbollit.
- Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin e shoqatës dhe anëtarët e bordit.
- Miraton plan-programin e këshillit profesional të FBK-ës, për punën e Shkollave të Minibasketbollit.
- Kryejnë edhe punë të përcaktuara në këtë Statut.

Neni 10

Kuvendi mblidhet sipas rregullit, së paku njëherë në vit. Kuvendi themelohet dhe me të udhëheq kryetari i shoqatës. Kuvendi detyrimisht mblidhet me kërkesën e bordit drejtues të shoqatës apo të më së paku $\frac{1}{4}$ -tave të anëtarëve të Kuvendit.

Neni 11

- Kuvendi mund të mblidhet nëse janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve.
- Kuvendi vendos me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Kuvendit.
- Kuvendi aprovon ndryshimet dhe plotësimet e statutit, me shumicën e votave të delegatëve prezent.

Neni 12

- Bordi drejtues është organ ekzekutiv i Kuvendit.
- Bordi drejtues numëron 5 anëtarë.
- Nga rradhët e bordit drejtues zgjidhet edhe kryetari i tij të cilit e emëron Kuvendi.

Neni 13

Anëtarët e bordit drejtues zgjidhen në periudhën prej 4 viteve dhe mund të rizgjidhen. Mandati i anëtarëve të bordit drejtues pushon para skadimit të kohës për të cilën janë zgjedhur:

- Nëse jep dorëheqje
- Nëse e shkarkon Kuvendi i shoqatës për shkak të mosrespektimit të Statutit dhe akteve tjera themelore.

Neni 14

Bordi kryen këto punë dhe detyra:

- Përcakton propozimin e statutit dhe akteve tjera themelore që sjell Kuvendi i shoqatës.
- Përcakton propozimin e planit financiar të shoqatës.
- Sjell aktet themelore që nuk janë në kompetenca të Kuvendit.
- Aprovon llogaritë përfundimtare të shoqatës.
- Përcakton programin e bashkëpunimit ndërkombëtarë në bashkëpunim me FBK-në.
- Kryen edhe punë tjera që nuk janë në fushëveprim të Kuvendit.

Neni 15

Bordi drejtues punon në mbledhjet që mbahen në bazë të nevojës. Mbledhjet e bordit drejtues i thërret kryetari i bordit drejtues, apo thirren me kërkesën e 4 anëtarëve të bordit drejtues.

-IV- KRYETARI I SHOQATËS

Neni 16

Kryetari i shoqatës dhe të Kuvendit e zgjedh Kuvendi i shoqatës me vota të fshehta nga rradhët e anëtarëve të Kuvendit.

Kryetari i shoqatës dhe i Kuvendit zgjidhet në periudhën prej më së paku 4 vjetësh dhe mund të rizgjidhet në po atë funksion edhe për një mandatë.

Kryetari i shoqatës dhe i kuvendit për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të shoqatës.

Neni 17

Kryetari i kryen këto detyra:

- Përfaqëson shoqatën
- Përfaqëson shoqatën në punët e pasurisë dhe punët tjera juridike dhe është udhëheqës për ekzekutimin e planit financiar të shoqatës.
- Udhëheq në punën e Kuvendit dhe bordit të shoqatës.
- Koordinon aktivitetin në mes të anëtarëve të shoqatës.
- Propozon emërimin e sekretarit/es të shoqatës.
- Përgjigjet për ligjshmërinë e punës së shoqatës.
- Kryen edhe punë të tjera në përputhje me statutin.

-V- SEKRETARI I SHOQATËS

Neni 18

Sekretari i shoqatës është organ ekzekutiv i bordit drejtues. E emëron bordi i shoqatës në propozim të bordit drejtues. Sekretari i shoqatës mbetet në funksion për aq sa është paraparë mbi angazhimin e tij, ndërsa kontrata mund të përpilohet për më së shumti 4 - vjet vlefshëmëri.

Neni 19

Sekretari i i shoqatës është anëtar i bordit drejtues nga funksioni. Funksionin e vet Sekretari/ja i shoqatës e kryen në mënyrë amatere ose profesionale për çka vendimin e sjell Kuvendi i Shoqatës.

Neni 20

Sekretari/ja i shoqatës:

- Koordinon bashkëpunimin mes FBK-së dhe shoqatës .
- Vendos kontakte me organizatat tjera të minibasketbollit nga vendet tjera, me qëllim të bashkëpunimit dhe këmbimit të informatave.
- Përkujdeset për përgatitjen dhe publikimin e informatave gjegjëse profesionale.
- Kryen edhe punë tjera profesionale të cilat ia beson Kuvendi, Kryetari i shoqatës dhe Bordi drejtues.

Neni 21

KËSHILLI MBIKËQYRËS

Këshilli mbikëqyrës është organ mbikëqyrës që kryen kontrollin mbi ligjshmërinë e punëve të shoqatës, zbatimit të statutit dhe të akteve dhe vendimeve tjera të shoqatës, si dhe kryen kontrollin material të afarizmit financiar të shoqatës.

Neni 22

Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës i zgjedh Kuvendi i Shoqatës. Këshilli mbikëqyrës numëron tre anëtarë, dy anëtarë zgjidhen nga anëtarët e Kuvendit (përfaqësuesit e shkollave të minibasketbollit) dhe një anëtarë nga FBK-ja.

Neni 23

Këshilli mbikëqyrës i raporton Kuvendit dhe Bordit drejtues lidhur me çështjet e fushëveprimit të vet së paku një here në vit.

Neni 24

Këshilli mbikëqyrës sjell vendimet e veta me shumicë votash nga numri i gjithmbarshëm i anëtarëve.

Neni 25

-VI- MJETET E SHOQATËS

Mjetet për punën e Shoqatës sigurohen me:

- Donacionet, ndihmat shtetërore dhe të ardhurat tjera
- Nga donacionet e FBK-së
- Marketingu
- Pagesën e kotizimeve nga anëtarësia dhe mjetet tjera të lejuara në bazë të ligjit.

-VII- AKTET E PËRGJITHËSHME

Aktet e përgjithshme të Shoqatës janë:Statuti dhe propozicionet e garave të Minibasketbollit. Iniciativën për ndryshime statutare dhe për ndryshime në propozicionet e garave mund të jap Kryetari i Shoqatës,Bordi drejtues,Sekretari dhe më së paku 5 anëtarë të Kuvendit. Iniciativën për ndryshimin e akteve normative e shqyrton bordi drejtues i shoqatës në afat prej 15 ditëve nga dita e sjelljes së iniciativës. Në rast se iniciativa pranohet,bordi e përcakton skicën e statutit dhe ia dorëzon kuvendit për aprovim.

-VIII- NDËRPRERJA E PUNËS

Neni 26

Shoqata punon së vepruari nën kushtet e parapara me ligj. Vendimi për ndërprerjen e punës e sjell Kuvendi i Shoqatës. Në rast të ndërprerjes së punës prona dhe mjetet e shoqatës kalojnë në organizatën që merr të drejtat dhe detyrat mbi Shoqatën.

-IX- DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 27

Ky statut hyn në fuqi ditën e miratimit në Kuvendin e Shoqatës së Minibasketbollit të FBK-së.

Prishtine_____

Prof.mr. Ismet Ferati

Kryetar i SHMFBK